

# AUDITUES ENERGJITIK NË INSTALIME INDUSTRIALE

## Rreth nesh



Audituesi i energjisë vlerëson dhe analizon se si energjia po përdoret në një objekt industrial duke identifikuar mundësitë e ruajtjes së energjisë si edhe duke bërë rekomandime se ku mund të reduktohet ose optimizohet konsumi energjetik.

Ekzistojnë tre lloje kryesore të auditimeve të energjisë: Auditimet e nivelit 1 (anketat e përgjithshme që ju lejojnë të identifikoni me shpejtësi mundësitë për kursimin e energjisë); Auditimet e nivelit 2 (analizat e vrojtimit të energjisë që përdoren zakonisht në ndërtesat tregtare); dhe Auditimet e Nivelit 3 (analiza të detajuara të modifikimeve me kapital intensiv).

Programi 12 javor i Audituesit të Certifikuar të Energjisë instalime industriale u ofron pjesëmarrësve njohuritë themelore të nevojshme për të vlerësuar se si përdoret energjia në procese industriale dhe për të identifikuar se ku mund të reduktohet konsumi. Për më tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme të llogaritjes përmes shembujve praktikë dhe skenarëve të mundshëm kompjuterik.

Ky është kursi i duhur për ju nëse jeni ose do të përfshiheni në auditimet e instalimeve industriale dhe ju nevojitet të zgjeroni njohuritë tuaja për procesin e plotë të analizës energjitike dhe të raportimit.

## OBJEKTIVAT KRYESORE

- Të kuptuarit të objektivave të auditeve energjitike dhe protokollet e tyre
- Analizimi i niveleve të ndryshme të auditit dhe planifikimi i suksesshëm i auditit
- Raportimi efektiv i rezultateve të auditit energjistik.
- Të kuptuarit të formave të energjisë, ndërlydhjes së njësive, strukturat e raporteve dhe vlerësimi i tyre.
- Analizimi i konsumit energjistik në procese industriale dhe përcaktimi i balancave energjitike.
- Si të përcaktohet informacioni i nevojshëm përpara dhe gjatë vizitave në terren dhe si të analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Aftësimi në përdorimin e metodologjive dhe programeve kompjuterike për analizë dhe për vendim-marrje në investime të projekteve pavarësisht natyrës së tyre; fokusi kryesor mbeten projektet në efikasitetin e energjisë.
- Të kuptuarit të koncepteve dhe karakteristikave të sistemeve energjitike.
- Rritja e standartit profesional të specialistëve në fushën e efikasitetit të energjisë.

## GRUPET E INTERESIT

- Inxhinierët energjistik dhe konsulentë
- Auditues të rinj të energjisë
- Menaxherë të energjisë
- Profesionistë të kompanive të shërbimeve energjitike (ESCO)
- Profesionistë të çertifikimit të performancës energjitike (EPC)
- Organizata në zhvillimin e projekteve energjitike



## MODULET:

### AUDITUES ENERGJITIK NË INSTALIME INDUSTRIALE

- Legjislacioni mbi Efikasitetin e Energjisë;
- Burimet kryesore të energjisë;
- Njohja e proceseve të përpunimit të lëndëve të para të ndërtimit dhe nevoja për energji të sistemeve industriale të prodhimit;
- Matja e performancës në sistemet teknike industriale;
- Sistemet e ajrit të kompresuar;
- Pompat e fluideve të lëngshëm dhe sistemet grupeve të presionit;
- Sistemet elektrike;
- Motorrët elektrikë;
- Këmbyesit e nxehtësisë;
- Kogjenerimi dhe kaldajat FCB (Fluidised Bed Combustion);
- Gjeneratorët e nxehtësisë;
- Rekuperimi i nxehtësisë;
- Konceptet bazë të analizës së një projekti të energjive të pastra;
- Laborator/ Praktikë Profesionale dhe programe kompjuterike;
- Analizë dhe vlerësim teknik-ekonomik i investimit për kursimin e energjisë;